

مقدمة و غلاف المنتقى من موسوعة الأحاديث النبوية

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!

Parathënie

Çdo lavdërim i takon Allahut, Zotit të botëve.
Salavatet dhe selamet qofshin për profetin tonë,
Muhamedin, familjen e mbarë shokët e tij dhe mbi
gjithë ata që i ndjekin në besim dhe në punë të mira
deri në Ditën e Llogarisë.

Gjëja më madhështore që duhet t'i kushtojë
rëndësi muslimani për lexim, përsiatje, meditim,
dije dhe veprim, - pas Librit të Allahut, - është
Suneti - hadithi i të Dërguarit të Allahut ﷺ. Profeti ﷺ
ka thënë:

«تَرَكْتُ فِيكُمْ أَيْهَا النَّاسُ، مَا إِنْ اعْتَصَمْتُمْ بِهِ، فَلَنْ تَضِلُّوا أَبَدًا: كِتَابُ اللَّهِ، وَسُنَّةُ
نَبِيِّهِ»

"O ju njerëz! Ju kam lënë në mesin tuaj ato gjëra që,
nëse kapeni për to, kurrsesi nuk do të devijoni:
Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij!" E
shënon imam Maliku. Allahu i Lartësuar thotë:

{وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا}

"Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni, e
çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj." (El
Hashër, 7) Andaj, "Shoqata për Shërbimin e
Përmbajtjes Islame në Gjuhë të Ndryshme" dhe
"Shoqata për Thirrje dhe Ndërgjegjësim të
Komuniteteve", në Rabva, u përkujdesën për të
përgatitur një enciklopedi të haditheve të Profetit
dhe për t'i përkthyer ato në gjuhë të ndryshme.

Allahu i Lartmadhëruar e ka lehtësuar përzgjedhjen e një pjese të kësaj enciklopedie, për të cilën muslimani ka nevojë në çështjet e fesë dhe të kësaj bote, duke i shpjeguar shkurtimisht, duke i sqaruar kuptimet e tyre, duke sjellë disa dobi dhe duke i vendosur në këtë libër, i cili titullohet: "Përzgjedhje nga Enciklopedia e Haditheve Profetike", Po punohet për përkthimin e tyre në të gjitha gjuhët ekzistuese të botës, që dobia e përmbajtjes së tyre të përhapet gjithandej dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut ﷺ t'i arrijë njerëzimit në gjuhët e tyre.

E lusim Allahun ta pranojë këtë vepër dhe ta bëjë të begatë, të sinqertë për hir të Tij, si dhe t'i shpërblejë të gjithë ata që ndihmuan në përgatitjen, përkthimin dhe shpërndarjen e saj!

Salavatet dhe selamet qofshin për profetin tonë Muhamed!

Përmbledhje e shkurtër

Hadithet profetike janë burimi i dytë i legjislacionit islam. Allahu i Lartësuar thotë:

{وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ (۳) إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ}

"Ai nuk flet sipas qejfit të vet,
por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore,
që i vjen atij." (En Nexhm, 3-4)

Kjo përzgjedhje nga "Enciklopedia e Haditheve" përfshin një gamë të haditheve gjithëpërfshirëse, për të cilat muslimani ka nevojë për çështjet e fesë

dhe të kësaj bote, duke i shpjeguar shkurtimisht, duke i sqaruar kuptimet e tyre dhe duke theksuar disa dobi të përkthyer në të gjitha gjuhët ekzistuese të botës, që dobia e përmbajtjes së tyre të përhapet gjithandej dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut ﷺ t'i arrijë njerëzimit në gjuhët e tyre.

Përmbajtja

No table of contents entries found

sq375v1.0 - 04/09/2026